



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË / OSNOVNI SUD MITROVICA

AD.GJTHM.nr.06/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, Nënkryetari i Gjykatës Bekim Veliqi, duke vendosur në çështjen disiplinore të ngritur ndaj F.Xh, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtrri, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga pala I.A dhe pranimit të deklaratës së Gjyqtarit F.Xh, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 19.07.2023, merre këtë;

A K T V E N D I M

REFUZOHET Ankesa disiplinore e dt.22.06.2023, e regjistruar me numër të lëndës AD.GJTHM.nr.06/2023, e parashtruar nga pala ankuese I.A nga fshati ..., Komuna Podujevë, kundër Gjyqtarit F.Xh, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri, e **PA BAZUAR**.

Arsyetim

Në cilësinë e autoritetit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë në rrethanat aktuale, me dt.22.06.2023, kam pranuar ankesën nga pala I.A nga fshati ..., Komuna Podujevë, kundër F.Xh, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri.

Pala ankuese I.A në ankesë cekë shqetësimet dhe pretendime të tij në lidhje me gjyqtarin e çështjes F. Xh, duke theksuar se me aktgjykimin P.nr.435/20 i njëjti I.A është dënuar me gjobë në shumë prej 800 euro në kundërshtim me provat materiale, pra në bazë të provave nuk ka arritur të vërtetojë pretendimet e palës së dëmtuar dhe kështu ka dëmtuar sigurinë juridike të tij, edhe pse pala dëshmitare ka dhënë deklaratë të ndryshme në prokurori dhe të ndryshme në gjykata, duke theksuar se gjyqtari ka marrë për bazë vetëm atë që ju ka përshtatë, ka theksuar edhe aktgjykimin P.10/23 ndaj palës F.P ku e njëjta është dënuar me gjobë në shumë prej 200 euro, dhe gjyqtari nuk merr për bazë aktgjykimet P.nr.344/20 të dt.01.07.2020 dhe P.nr.344/20 të dt.23.02.2021, të kësaj gjykate, me arsyet e tjera siç konstatohen në ankesë.

Autoriteti kompetent në rastin konkret ka marrë veprime procedurale pas pranimit të ankesës, ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj subjektit të hetimit-gjyqtarit, i cili ka dhënë deklaratë me shkrim lidhur me ankesën e palës I.A, ka theksuar lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesi, duke theksuar se nuk ka çka të thotë më tepër se që ka thënë në aktgjykimin P.nr.435/20, ashtu siç nuk ka çfarë të shton më tepër për aktgjykimin P.nr.10/23, kundër bashkëshortes së tij. Në këto raste ka vendosur sipas bindjes së lirë dhe provave materiale dhe pa asnjë favorizim për njërin apo tjetër palë. Të gjitha pretendimet tjera janë të palës ankuese se njihet dhe është i ndikuar nga M.P vëllai i F., nuk e njeh dhe nuk mund të ndikohet. Pretendimi se gjyqtari i merr lëndët ku paraqitet pala I.A, nuk qëndron ky pretendim pasi që lëndët gjyqtarëve i ndahen përmes sistemit të Smili-it. Gjithashtu ankuesi shpreh mosbesim dhe dyshon në gjyqtarët tjerë si dhe kërkon përjashtimin e tij nga procedimi i lëndës.

Nga të gjitha këto kërkoj që ankesa disiplinore është e pa bazuar dhe si e tillë të refuzohet.

Pas shqyrtimit të kërkesës-ankeses së palës ankuese, kërkesa-ankesa si e tillë është konsideruar e pabazuar për faktin se Gjyqtari i çështjes, në deklaratën e dhënë ka theksuar se pas analizimit të ankesës së parashtruar nga pala ka konstatuar se aktgjykimet e cekura nga pala ankuese, gjyqtari i çështjes i ka marrë pas analizimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, por në ankesë në tërësi është shfaqje e pakënaqësisë në lidhje më mënyrën e vendosjes, lidhur me pretendimin se gjyqtari merret me lëndët ku paraqitet pala I.A, pretendimet e tilla nuk qëndrojnë sepse lëndët gjyqtarit i ndahet sipas sistemit të

Smili-it, ndërsa sa i përket pretendimit se shpreh mosbesim të gjykata dhe te gjyqtarët, pala me kërkesë të veçantë duhet të kërkoj përjashtimin e gjyqtarit të çështjes, andaj mbi këto arsye nuk qëndrojnë asnjë pretendim për shkeljet disiplinore, andaj në bazë të lartcekurave rrjedhë që ankesa të refuzohet e pabazuar.

Andaj autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tillë është e pabazuar, pretendimet për shkeljet konkret të Ligjit për Përgjegjësi disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror janë të pa qëndrueshme, nuk kemi asnjë dyshimi të qëndrueshëm për veprimet të mëtejshme procedurale në raport me subjektin e hetimit duke marrë për bazë përgjigjen e marrë nga gjyqtari ndaj të cilit është ngritur procedura disiplinore, i cili në mënyrë përmbajtjesore ka shpjeguar veprimet e ndërmarra lidhur me aktgjykimet P.nr.435/20 dhe P.10/23, se çështja e vendosjes lidhur me lëndën i përket gjyqtarit të çështjes pakënaqësitë e palëve të marrja e vendimit nga ana e Gjykatës si shkallë parë, nuk mund të konsiderohet edhe shkelje disiplinore.

Janë të paqëndrueshme pretendimet e palës lidhur me ndarjen e lëndëve, pasi që lëndët gjyqtarëve ju ndahen në mënyrë automatike sipas sistemit të Smil-it, ku gjyqtarët nuk kanë fare çasje të mënyra e ndarjes së lendeve. Sa i përket pretendimit lidhur me mosbesimin të gjykatës dhe dyshimit edhe në gjyqtarët tjetër, ku pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se pala duhet të paraqes kërkesë për përjashtim të gjyqtarit të çështje duke i cek arsyet për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes, ku më pas vendos gjykata lidhur me përjashtimin e gjyqtarit.

Asnjë person autoritet tjetër nuk e ka të drejtën e ushtrimit të ndikimit me rastin e vendosjes së kërkesës nga palët në procedurë, vendosja i përket gjyqtarit si e drejtë ligjore gjithmonë duke u bazuar në prova dhe palët pakënaqësitë e tyre, e kanë mundësin ligjore të ushtrimit të mjeteve juridike, pasi që ekzistojnë shkallëshmëria për shqyrtimin vendimeve gjyqësore mbi ligjshmërinë apo paligjshmërinë e tyre me rastin e vendosjes

Nga arsyet e theksuara me larte, ne mbështetje të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

AD.GJTHM.nr.06/2023, dt.19.07.2023

Nënkryetari i Gjykatës

Bekim Veliqi

Aktvendimi i dërgohet;

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës**
- 2. Parashtruesit të ankesës I.A**
- 3. Gjyqtarit F.Xh**